


01-2066



Në bazë të nenit 21, 22, 44 dhe 50 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 17, pika “d” të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, duke vendosur sipas detyrës zyrtare, me datë 10.08.2021, merr këtë:

V E N D I M

PËR KORRIGJIMIN E AKTIT ADMINISTRATIV “VENDIM PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE” 05 NR. 350/02-211850/20 DT. 10.06.2021

I. Korrigjohet akti administrativ “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore” 05 Nr. 350/02-211850/20 dt. 10.06.2021, i kësaj drejtorie, i lëshuar në emër të aplikuesve Afërdita Brahimi, Jonuz Fetahu dhe Nusret Vllasaliu nga Prishtina, dhe investitorit “Koral Invest” LLC, me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 810125486, dhe me pronar Kushtrim Isufi nga Prishtina, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesë shumë banesore dhe afariste – “Ndërtesa KF 10”, me etazhitet – B+S+P+10, në kuadër të parcelës ndërtimore “F-10-2” të bllokut urban “F-10”, të tërësisë urbane “F”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim” në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 424-3, 424-4 dhe 424-17 ZK Çagllavicë.

Korrigjimi bëhet në pikën I, të dispozitivit të aktit administrativ të referuar, te pjesa e shënimit të etazhitetit të ndërtesës së planifikuar “Ndërtesa KF10”, dhe atë, në vend të “-B+S+P+10” duhet të jetë “-B+S+P+8”.

II. Me këtë vendim korrigjohet akti administrativ “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore” 05 Nr. 350/02-211850/20 dt. 10.06.2021, dhe i njëjti do të prodhojë efekt juridik nga dita e miratimit të tij.

A r s y e t i m

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, me aktin administrativ “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore” 05 Nr. 350/02-211850/20 dt. 10.06.2021, u ka caktuar kushtet ndërtimore pronarëve Afërdita Brahimi, Jonuz Fetahu dhe Nusret Vllasaliu nga Prishtina, dhe investitorit “Koral Invest” LLC, me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 810125486, dhe me pronar Kushtrim Isufi nga Prishtina, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesë shumë banesore dhe afariste – “Ndërtesa KF 10”, me etazhitet – B+S+P+10, në kuadër të parcelës ndërtimore “F-10-2” të bllokut urban “F-10”, të tërësisë urbane “F”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim” në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 424-3, 424-4 dhe 424-17 ZK Çagllavicë

Në ndërkohë, ky organ ka vërejtur se në aktin administrativ të referuar, ka rrjedhur një gabim teknik, gjegjësisht në pikën I të dispozitivit të të njëjtit akt, është shënuar gabim etazhiteti i ndërtesës së planifikuar “Ndërtesa KF10” –B+S+P+10, ku i njëjti duhet të jetë –B+S+P+8, dhe sipas detyrës zyrtare, pas verifikimit të situacionit të bashkëngjitur aktit të referuar, korrigjohet gabimi i lëshuar, sipas përshkrimit në pikën I të dispozitivit të këtij akti.

Bazuar në dispozitat ligjore të përmendura, ky organ vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

qytetarë.

Kopja elektronike i dërgohet: Drejtorisë së Pronës, Drejtorisë së Kadastrit dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 350/02-211850/20 DT. 10.08.2021**

Zyrtari,
Nazife Krasniqi

U.D. Udhëheqëse e Sektorit,
Mimoza Berisha Prestreshi

Drejtori,
Ardian Olluri

